REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 10 Nr. Br. 16309
Nr. i faq. 1 Data: Datum: 01/07
KAMENICE/A 2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektoratit dhe Emergjenca**
**Nr.10/158 datë 01.07.2025**

Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe nenit 4 të Statutit të Komunës së Kamenicës, (statuti 01, Nr.20203 datë 21.06.2023), nenit 5 paragrafi 5.1; neni 20 paragrafi 20.2; i Ligjit për rrugët (Ligji Nr.2003/11), rregullorja për organizimin e brendshëm të Administratës Komunale në Komunën e Kamenicës, si dhe kërkesës z.Imran Morina, menaxher i projektit për Rregullimin e Infrastrukturës në rrugën kryesore-asfaltimin e rrugëve, Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjenca, nxjerr këtë :

## V E N D I M

1. **Lejohet mbyllja e përkohshme e segmentit të rrugës "Sylë Zarbinca", nga ura në hyrje të qytetit, deri te ujëmbledhësi përballë rrugës "Fehmi Agani", nga ora 07:00 - 17:00 h, datë 02.07.2025;**
2. **Lejohet mbyllja e përkohshme e segmentit të rrugës duke filluar nga ujëmbledhësi përballë rrugës "Fehmi Agani" deri te rrethi në qendër, duke filluar nga ora 07:00 - 17:00 h, datë 03.07.2025;**
3. **Kërkohet nga policia e Kosovës, stacioni në Kamenicë që të asistoj në drejtimin e komunikacionit, dhe automjetet të orientohen në rrugët alternative;**
4. **Obligohet OE, El-Bau, që të vendosë sinjalizimin përkatës dhe të orientoj lëvizjen e automjeteve në rrugët alternative;**

## A r s y e t i m

Mbyllja e përkohshme e rrugëve si në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, bëhet për arsye të asfaltimit të tyre, nga kompania El-Bau, e kontraktuar nga Komuna.

Vendimi t'i dorëzohet:

- DSHPAIE;
- Policisë së Kosovës, stacioni në Kamenicë;
- Zyrës së Informimit;

REPUBLIKA E KOSOVES · KOMUNA E KAMENICËS · REPUBLIKA KOSOVA · OPŠTINA KAMENICA

**Personi Përgjegjës**

**Hysen JERLIU**